



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

## DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

RELACION Korçë, më 15 . 01 .2024

### PËR NJË NDRYSHIM TË VKB Nr.141 DATË 26.10.2023 MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”

Në zbatim të pikës 2 të Vendimit Nr.141 datë 26.10.2023 të Këshillit Bashkisë Korçë “Mbi miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi i strehimit social “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, ngarkohen institucionet financiare Banka Raiffeisen, Banka Intesa Sanpaolo dhe mungon Banka Kombëtare Tregtare .

Sqarojmë se Bashkia Korçë vazhdon të ketë akoma kuotave të lira të cilat na janë siguruar në zbatim të Marrëveshjes Dypalëshe “Për Kreditimin në Kuadër të Programit të Banesave me Kosto të Ulët për Familjet që Përfitojnë Subvencionimin e Interesave të Kredisë” nënshkruar midis palëve, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me bankat e nivelit të dytë Banka Kombëtare Tregtare, RaiffeisenBank dhe Banka Intesa San Paolo, dhe për këtë arsye del e nevojshme të plotësojmë me ndryshimpikën 2 të vendimit si më poshtë:

“Familjet e përcaktuara në listën fituese të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucioneve financiare si: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa Sanpaolo mbas njoftimit zyrtar që kryen Bashkia Korçë”.

Ky ndryshim diktohet mbas përditësimit të informacionit që ka dërguar në muajin Janar EKB ku rezultojnë në total 72 familje përfituese që e kanë përfunduar procedurën me bankat ,por dhe 17 familje që janë në proces dhe rastet me shtyrje afati, vazhdon zbatimi i kuotave të lira në dispozicion të programit,ku do të përfshihen te 3 bankat e cituara më sipër. Në këtë mënyrë del e arsyeshme rivendosja e Bankës Kombëtare Tregtare si pjesë e zbatimit të vendimit për të bërë të mundur vazhdimin e procedurës pa pengesa për qytetarët.

Në zbatim të :

- Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”,
- Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Sociali ndryshuar, neni 15,16, 47, 47/1,
- VKM nr.384, datë 12.06.2019,“Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”,
- VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”,
- VKM Nr.268 datë 29.04.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.453,datë 3.07.2019.”Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet,që përfitojnë banesë me kosto të ulët ,me kredi të lehtësuar nga shteti”,

-V.K.B. nr.96 datë 27.07.2023 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencioni i interesave të kredisë” ,mbas vlerësimit dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit , kërkohet ndryshimin vetëm të pikës 2 të VKB nr. 141 datë 26.10.2024 me qëllim përfshirjen në këtë pikë edhe të Bankës Kombëtare Tregtare për zbatimin e këtij vendimi.Pikat 1 dhe 3 e VKB Nr. Nr.141 datë 26.10.2023 të Këshillit Bashkisë Korçë “Mbi miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi i strehimit social “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, nuk kanë ndryshime,ndryshon vetëm pika 2 e tij.

Drejtoresh/Drejtoreshia e Strehimit Social dhe Drejtoresh/Drejtoreshia e Përgjithshme Juridike  
Menaxhimit të Banesave Sociale. dhe Burimeve Njerëzore.  
**Mirela Balli** **Anxhela (Dishnica) Qeramixhi**

**KRYETARE E KOMISIONIT TË STREHIMIT**  
**Benila THEMELI**

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Sotiraq FILO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM**

Nr., datë .2024

**PËR**

**NJË NDRYSHIM TË VKB Nr.141 DATË 26.10.2023 MBI MIRATIMIN E  
FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL  
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social, nenin 15,16, 47, 47/1, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, “VKM 384, datë 12.06.2019,“Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”VKM nr.453,date 3.07.2019.”për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet,që përfitojnë banesë me kosto të ulët ,me kredi të lehtësuar nga shteti”,i ndryshuar me VKM nr.268, VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit” dhe V.K.B. nr.96 datë 27.07.2023 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit, “Subvencioni i interesave të kredisë”, bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe me vlerësimin e Komisionit të Strehimit,Këshilli Bashkiak Korçë,

**VENDOSI:**

- 1.Familjet e përcaktuara në listën fituese, të VKB Nr.141 datë 26.10.2023 të Këshillit Bashkiak Korçë “Mbi miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi i strehimit social “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, të paraqiten pranë institucioneve financiare si: Banka Kombëtare Tregtare, Banka Raiffeisen dhe Banka Intesa SanPaolo,mbas njoftimit zyrtarqë kryen Bashkia Korçë.
- 2.Familjet përfituese të VKB nr.141 datë 26.10.2023,të cilat kanë filluar procesin e marjes së kredisë me Bankën Kombëtare Tregtare, të vazhdojnëprocedurën më tej deri në përfundim të saj.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10-ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak**Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Eva NAÇIANA VERUSHI**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota

Vota Pro\_\_\_\_\_

Vota Kundër\_\_\_\_\_

Vota Abstenim\_\_\_\_\_

Zbardhur më datë \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr., datë .2024

**PËR**  
**NJË NDRYSHIM TË VKB Nr.141 DATË 26.10.2023 MBI MIRATIMIN E**  
**FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL**  
**“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social, nenin 15,16,47,47/1, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, “VKM 384, datë 12.06.2019,“Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”VKM nr.453,datë 3.07.2019.”per masen e subvencionit te interesave te kredise dhe procedurën e dhënies së tij për familjet,që përfitojnë banesë me kosto të ulët ,me kredi të lehtësuar nga shteti”,i ndryshuar me VKM nr.268, VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit” dhe V.K.B. nr.96 datë 27.07.2023 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit, “Subvencioni i interesave të kredisë”, bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

- 1.Familjet e përcaktuara në listën fituese, të VKB Nr.141 datë 26.10.2023 të Këshillit Bashkisë Korçë “Mbi miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi i strehimit social “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, të paraqiten pranë institucioneve financiare si:  
Banka Kombëtare Tregtare, Banka Raiffeisen dhe Banka Intesa SanPaolo mbas njoftimit zyrtar që kryen Bashkia Korçë.
- 2.Familjet përfituese të VKB nr.141 datë 26.10.2023,të cilat kanë filluar procesin e marjes së kredisë me Bankën Kombëtare Tregtare, të vazhdojnë procedurën më tej deri në përfundim të saj.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10-ditë pas shpalljes

Sekretari i Këshillit Bashkiak **Kryetar i Këshillit Bashkiak**  
**Eva NAÇI Ana VERUSHI**

Miratuar me \_\_\_\_\_ vota

Vota Pro \_\_\_\_\_

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_  
Zbardhur më datë \_\_\_\_\_

